

# Masat që merren nga 7 marsi

**Qeveria ka vënë rregulla për të ndaluar koronavirusin. Rrespektoji rregullat! Kështu ti nuk sëmuresh, apo nuk mund të sëmuresh asnjëri. Policia mund të të kontrollojë.**

Vini re: Disa qytete/bashki dhe komuna kanë rregulla më të rrepta. Shiko faqen e internetit të qytetit/bashkisë apo të komunës!

## Çfarë të rejash ka?

---

Këto janë rregullat e vetme:

- Mbaj/Vendos gjithmonë një maskë për gojë në tren, tramvaj dhe autobus dhe në një institucion kujdesi, për shembull në spital apo qendër strehimi me kujdes/azile pleqësh!
- Respekto rregullat mbi udhëtimet!

## Maskat për gojë

---

- Nëse je 12vjeç, ose ke moshë më të madhe, atëherë maska për gojë është e detyrueshme.
  - Në mjetet e transportit publik.
  - Në institucionet e kujdesit: për shembull në spital apo qendër strehimi me kujdes/azile pleqësh.
- Nëse je në një vend me shumë njerëz, atëherë është mira t'a mbash/vendosësh një maskë për gojë.

## Udhëtime jashtë shtetit

---

- Nëse udhëton jashtë shtetit, atëherë janë disa kode me ngjyra :
  - Gri: rajon ose shtet për të cilin ka pak informacione. Është mira të mos udhëtosh për atje.
  - E kuqe e mbyllur/errët: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të madh për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
  - Portokalle ose e kuqe: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të mesëm për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
  - Jeshil/ e gjelbër: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të vogël për koronavirus. Por ti mund të udhëtosh për atje.
  - Shiko tek faqja e internetit <https://www.info-coronavirus.be/nl/keurcodes-per-land/>
- Shiko në [diplomatie.belgium.be](https://diplomatie.belgium.be) se cilat rregulla janë në shtetin ku ti do të shkosh!

## Nëse kthehesh nga një shtet të Bashkimit Evropian

Ishe në udhëtim jashtë shtetit për më gjatë se 48 orë?

- Ke një çertifikatë ku shkruhet se:
  - ka së paku 14 ditë që je vaksinuar plotësisht,
  - ose që ke pasur rezultat negativ të testit për koronavirus (maksimumi para 72 orësh),
  - ose që të ka rënë kohët e fundit koronavirusi (jo më gjatë se para 180 ditësh)?

Atëherë ti nuk duhet të bësh test, as të futesh në karantinë.

- Nuk ke çertifikatë? Vjen nga një zonë e kuqe e mbyllur/errët ose gri? Atëherë ti duhet të bësh test në ditën 1.

## Nëse kthehesh nga një shtet jashtë Bashkimit Evropian

Ishe në udhëtim jashtë shtetit për më gjatë se 48 orë?

- Plotëso formularin në: <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form> para se të kthehesh në Belgjikë!
- Ke një çertifikatë ku shkruhet se:
  - ka së paku 14 ditë që je vaksinuar plotësisht,
  - ose që ke pasur rezultat negativ të testit për koronavirus (maksimumi para 72 orësh),
  - ose që të ka rënë kohët e fundit koronavirusi (jo më gjatë se para 180 ditësh)?

Atëherë ti nuk duhet të bësh test, as të futesh në karantinë.

- Nuk ke çertifikatë? Vjen nga një zonë e kuqe e mbyllur/errët ose gri? Atëherë ti duhet të bësh test në ditën 1.

## Nëse kthehesh nga një shtet me rrezik shumë të madh?

Vjen nga një zonë me rrezik shumë të madh?

- Një listë të këtyre zonave e gjen në <https://info-coronavirus.be/nl/hoog-risicolanden/>
- Nëse ky është një shtet jashtë Bashkimit Evropian atëherë :
  - Është e detyrueshme të futesh për 10 ditë në karantinë. Kjo vlen për të gjithë.
  - Bëj test në ditën 1 dhe 7 pasi je kthyer në Belgjikë!
- Nëse ky është një shtet brenda Bashkimit Evropian ose Zonës Shengen dhe :
  - Nuk ke çertifikatë vaksinimi? Atëherë bëj test në ditën 1 pasi je kthyer në shtëpi!
  - Nëse testi yt është negativ, atëherë lejohet të dalësh nga karantina. Pastaj bëj edhe një herë test në ditën 7!
  - Nëse një test është pozitiv, atëherë ti duhet detyrimisht të futesh 7 ditë në izolim.

**Këta rregulla janë të rëndësishëm për shëndetin e gjithësecilit. Gjithësecili duhet t'i rrespektojë ata. Faleminderit që do të bësh këtë gjë. Së bashku, ne e ndalojmë koronavirusin.**